

VENDIM
Nr.665, datë 10.10.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.579, DATË 8.9.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KTHIMIN E VLERAVE FINANCIARE TË
KREDITORËVE QË KANË DEPOZITUAR KAPITALET E TYRE PRANË SHOQËRIVE
HUAMARRËSE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 13 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë“, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 11 të vendimit nr.579, datë 8.9.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kreditorëve, që kapitalet e tyre i kanë depozituar në shoqëritë “Gjallica”, “Beno” e “Nahlel” sh.p.k., në administrim, nuk do t’u kërkohet, përjashtimisht, mandatarkëtimi i depozitimit të parave, nga që nuk disponohen në këto shoqëri, për tërheqjen e vlerave financiare pranë sporteleve të bankave.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha